



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER
NJËSIA E PROKURIMIT



Nr. _____ prot.

Fier, më 23.03.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës -Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “MIRËMBAJTJE FULL RISK PËR “CT””

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodet CPV: 50800000-3 “Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje”.

**VLERA E FONDIT LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë
Marrëveshjes Kuadër: 15,800,000 (pesëmbëdhjetë milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitalit Rajonal “Memorial” Fier” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;
- b. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kriteri Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri 2.2.1 Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e ulët se 15 800 000 lekë (pra kjo vlerë e xhiros minimale vjetore nuk tejkalon vlerën e parashikuar të kësaj kontrate).

Argumentimi për Kriterin 2.2.1: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Referuar parashikimeve ligjore të nenit 43, pika 2, germa ”b”, për procedurat me objekt mallra me fond limit ndërmjet kufirit të ulët dhe të lartë monetar, siç është rasti i kësaj procedure, maksimumi i xhiros vjetore të kërkuar nuk duhet të tejkalojë vlerën e parashikuar të kësaj kontrate.

Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për shërbime të mëparshme të ngjashme për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit , në një vlerë jo më të ulët se 6 300 000 lekë (pra kjo vlerë totale e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë tre viteve të fundit , nuk tejkalon 40% të vlerës së parashikuar të kësaj kontrate).

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi kriteri 2.3.1: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 41 dhe 47 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar . Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën e cila nuk tejkalon fondin limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorit Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar të paktën një inxhinier për mirëmbajtjen e pajisjes objekt e këtij prokurimi. Për këtë duhet të paraqiten:

- Kontratë punë
- CV e specialistit dhe çertifikatat/dëshmitë profesionale përkatëse.

Argumentimi për kriterin 2.3.2: Ky kriter vendoset ne perputhje me nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së ofrimit të shërbimit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatorit Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë që merr përsipër kryerjen e mirëmbajtjes të tipit Full Risk sipas rekomandimeve te prodhuesit;

2.3.4 Operatorit Eonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë nje deklarate që merr përsipër zevendesimin e pjesëve te këmbimit dhe konsumit, që ato do jenë të reja dhe origjinale dhe ne përputhje me ato te përdorura fillimisht (te garantuara nepermjet certifikimit CE) dhe që përfshihen në vlerën e kontratës dhe se garancia e pjesëve të këmbimit do të jetë për një periudhë jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit;

Argumentimi për kriterin 2.3.3 dhe 2.3.4 : Këto kriter vendosen ne perputhje me nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses te kontrates pra te garancisë së ofrimit të shërbimit objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese e pajisjeve qe do te mirembaje ose nga distributor të autorizuar, për këtë procedurë prokurimi, për ofrimin e shërbimit të ofruar.

Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar të provohet lidhja me prodhuesin nepermjet dokumentacionit perkates.

Argumentimi për kriterin 2.3.5 : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: Pika 5. *”Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/entikontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.* Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor i autorizuar prej prodhuesit është një dokument i domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që OE ofertues është në gjendje të realizojë shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet nga ana e njësisë së prokurimit si e nevojshne për realizimin me sukses të kontratës

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që pranon oraret e kryerjes së shërbimeve dhe shpejtësinë e ndërhyrjeve;

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë planin e veprimeve të mirëmbajtjes parandaluese që ofertuesi do të ndërmarrë, për secilin grup pajisjesh, ku të përcaktohen periodiciteti, procedurat operative dhe protokollet që do të përdorë përfshirë kalibrimet dhe testimet periodike të sigurisë elektrike dhe mekanike të pajisjeve në përputhje me standartet përkatëse evropiane.

Argumentimi për kriteret 2.3.6 dhe 2.3.7 : Këto kritere vendosen në përputhje me nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe kjo kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së ofrimit të shërbimit objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikime teknike

- ❖ Kompania e cila do të kryejë mirëmbajtjen e aparatit të Skaner CT G&E model Revolution EVO 128 slajds mban përgjegjësi të plotë për çdo difekt dhe riparim që do të kryhet në këtë aparat.
- ❖ Për çdo difekt të cilin ky aparat do të pësojë gjatë periudhës së mirëmbajtjes kompania duhet të paraqitet brenda 24 orëve për konstatimin dhe riparimin e saj.
- ❖ Në rast nevojë të ndërrimeve të pjesëve të dëmtuara, është përgjegjësi e kompanisë ti çmontojë, dhe ti nderrojë me pjesë të reja, dhe çdo mirëmbajtje ose servis të dokumentohet.
- Në mirëmbajtjen e aparatit të CT Skaner do të përfshijë :
 - **Verifikimin e gjëndjes :**
 - Është i kompletuar
 - Është i montuar në rregull
 - Ka dëmtime të jashtme

- **Mirëmbajtje parandaluese**

Kontroll i mirëfunksionimit të ventilatorëve të Gantrit, Pastrim i tyre nga debridet e pluhurit.
Pastrim i shkëmbyesit të nxehtësisë nga debridet e pluhurit, kontrolli i mirëfunksionimit të ventilatorit
Pastrime të DAS (Data Acquisition System)
Pastrim dhe lubrifikim i vidës së pafundme që bën të mundur lëvizjen horizontale të shtratit
Kontroll dhe mirëmbajtje të kompiuterit, serverit dhe sistemit operativ
Kontroll dhe mirëmbajtje të HDD në raste mbushjeje

- **Kalibrim i aparatit**

- **Testim i sigurisë**

- Mekanike
- Elektrike

- Prova boshe
- Prova me ngarkesë

Me anë te proces-verbalit të mëposhtëm do të përshkruhen të gjitha veprimet që do të kryhen për mirëmbajtjen e aparatit, gjithashtu edhe gjëndja e aparatit:

PROCES VERBAL (Difekt – Kontroll / Sherbim Teknik -Riparim)		
<div style="text-align: center;">  </div> <p>SPITALI RAJONAL “MEMORIAL” FIER</p> <p>Adresa: Qëndër, Afrimi i ri , Rr. Grecalli nr.17, Daullas, Fier</p> <p>Tel: +355 (0) 34 22 99 76 Ëeb: www.srmemorial-fier.al</p>	<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Difekt</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Kontroll / Sherbim teknik</div> <div style="text-align: center;"><input type="checkbox"/> Riparim</div> </div> <p>Sot me _____ ne Repartin e _____</p> <p>Emri i pajisjes _____ Tipi _____</p> <p>Nr.Serise _____ Nr.ID _____</p> <p>Perdorur nga _____</p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; margin-top: 10px;"> <input type="checkbox"/> Garanci <input type="checkbox"/> Kontrate mirembajtje <input type="checkbox"/> Mirembahet nga vete spitali </div>	
Kompania e kontraktuar: _____ NIPT: _____ Adresa: _____ Administratori: _____		
VERIFIKIMI I GJENDJES		
TË PËRGJITHSHME:		
	Po	Jo
Është i kompletuar		
Është i montuar në rreg		
Ka dëmtime të jashtme		

MIRËMBAJTJA PARANDALUESE		
	Po	Jo
Kontroll i mirëfunksionimit të ventilatorëve të Gantrit, Pastrim i tyre nga debridet e pluhurit.		
Pastrim i shkëmbyesit të nxehtësisë nga debridet e pluhurit, kontrolli i mirëfunksionimit të ventilatorit		
Pastrime të DAS (Data Acquisition System)		
Pastrim dhe lubrifikim i vidës së pafundme që bën të mundur lëvizjen horizontale të shtratit		
Kontroll dhe mirembajtje te kompiuterit, serverit dhe sistemit operativ		
Kontroll dhe mirembajtje te HDD ne raste mbushjeje		
	Po	Jo
Kalibrimi		
TESTIMI I SGURISE		
	Po	Jo
Mekanike		
Elektrike		
Provat boshe		
Prova me ngarkese		
Aparati siguron parametat teknike		
MIRËMBAJTIE KORRIGJUESE		
Difekte të konstatuara :		

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizojnë produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik” operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vone se 5 dite nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

NJËSIA E PROKURIMIT: